



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Mehmet Muçaj (udhëheqës i ekipit), Natyra Kasumaj dhe Muharrem Qyqalla (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	24
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	35
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	38

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 22.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i ministrisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se vlera e pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€, e shpalosur në PFV ishte e mbivlerësuar, ndërsa pasuritë jo financiare nën 1,000€, ishin nënvlerësuar.

Gjithashtu, gjatë fazës së buxhetimit për vitin 2018, MASht kishte bërë keq klasifikime të shpenzimeve në disa kategori ekonomike.

Më gjerësisht për opinionin, shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Neni 19.3.1 Gjendja e pasurive jo financiare kapitale në PFV ishte mbivlerësuar për 3,145,448€. Kjo ka ndodhë për faktin që shkollat e ndërtuara nga MASHT, pas finalizimit nuk ishin transferuar te komunat si pronë e atyre shkollave. Përveç kësaj, kemi identifikuar

që tetë (8) projekte¹ në vlerë 846,971€, ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale mirëpo, për nga natyra ato projekte janë mallra dhe shërbime.

- Ligji nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës obligon MASHt-in që të ofrojë falas tekstet shkollore për nxënësit e nivelin I dhe II të arsimit parauniversitar. Bazuar në këtë, MASHt në vitin 2018, kishte buxhetuar dhe klasifikuar gabimisht 7,569,820€, nga investimet kapitale. Këto shpenzime ishin regjistruar në regjistrin e pasurive duke mbivlerësuar vlerën e pasurive të shpalosur në PFV. Vlen të theksohet se pas kërkesës të vazhdueshme nga MASHt drejtuar MF që kjo kategori mos të buxhetohet si kapitale, MF në buxhetin e viti 2019 kishte reflektuar duke buxhetuar blerjen e librave nga kategoria mallra dhe shërbime;
- Neni 19.3.2 Raporti për pasurinë jo financiare jo kapitale nën 1,000€ i PFV-ve, ishte nënvlerësuar për faktin se tetë (8)² nën programe të MASHt-it nuk e përdorin sistemin e pasuria, dhe si rezultat i kësaj, nuk kishin regjistruar të dhënat në këtë sistem; dhe
- Gjatë viti 2018 MASHt, përveç keqklasifikimit të përmendur tek blerja e librave kemi vërejtur se kishte bërë edhe 780,247€ keq klasifikime të cilat ishin planifikuar dhe realizuar nga kategoria investime kapitale për mallra dhe shërbime.

Lidhur me çështjet e përmendura më lart, ne nuk e kemi modifikuar opinionin e auditimit.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MASHt është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të

¹ Projektet e tilla janë: Furnizimi me pajisje për digitalizimin e bibliotekës në Universitetin Haxhi Zeka (UHZ); Furnizim me pajisje të TI për AAPARr; Furnizim me TI për nevoja të MASHt-it; Furnizim me pajisje të ndryshme dhe materiale tjera; Furnizim me inventar për salla të sportit në arsimin para universitar; Furnizim me inventar në shkollat e arsimit para universitar; Angazhim i ekspertëve për hartimin e normave dhe standardeve për hapësirat e objekteve parashkollore; Furnizimi dhe mbjellja e drunjtëve dekorative në Qendrën e Studentëve; Ndriçimi i fasadave të konvikteve me reflektor LED.

² Agjencia Kosovare e Akreditimit; Instituti Pedagogjik i Kosovës; Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve; Instituti Albanologjik i Kosovës; Agjencia për Aftësim dhe Arsim Profesional të të Rriturve; Qendra e Studentëve; Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"; Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka".

SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Organizatat Buxhetore kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013/MF-shpenzimi i parave publike, si dhe Rregulloren MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Draft PFV-të e ministrisë ishin keq deklaruar me vlera materiale nëpër zërat kryesor, por pas sugjerimeve tona ato ishin korrigjuar me 22.02.2019.

Lidhur me PFV-të, përveç çështjes së ngritur tek Theksimi i Çështjes, nuk kemi çështje tjetër që ndërlidhet me cilësinë e PFV.

DEKLARATA NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM DHE ZYRTARI KRYESOR FINANCIAR

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, me përjashtim të çështjeve të përmendura tek opinioni i auditimit.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi C1 Ministri duhet të ndërmerr veprime konkrete lidhur me bartjen e pronësisë për shkollat e ndërtuara nga MASHT te komunat përkatëse, dhe se këto pasuri duhet të largohen nga regjistri i pasurive të ministrisë. Më tej duhet të forcohen kontrollet për të siguruar se të gjitha programet që janë në kuadër të MASHT do të përdorin sistemin e e-pasurisë për të siguruar se pasuria jopakitale e prezantuar në PFV paraqet një pamje të drejtë dhe të saktë.

Gjithashtu, Ministri duhet të siguroj se projektet që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve të mos planifikohen në kategorinë e investimeve kapitale, por në kategorinë adekuate.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, fushën e prokurimit, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar, por një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsinë e shpenzimeve dhe shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi dhe realizimi i buxhetit, regjistrimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale, klasifikimi i duhur i shpenzimeve, menaxhimi i personelit, dhe raportimi i drejt i obligimeve të pa paguara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	58,003,626	56,331,888	49,447,601	41,528,363	47,892,635
Granti i Qeverisë -Buxheti	51,348,123	48,825,112	44,820,362	39,295,443	44,228,978
Financimi nga huamarrja	2,000,000	1,524,398	727,023	384,861	1,543,000
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	794,940	669,512	681,354	507,121
Të hyrat vetjake ⁴	2,655,503	2,655,503	1,018,084	1,032,422	946,897
Të hyrat nga AKP ⁵	2,000,000	2,000,000	1,999,677	-	-
Donacionet e brendshme	-	1,500	1,465	-	-
Donacionet e jashtme	-	530,435	211,478	134,283	666,639

Në vitin 2018, ministria ka shpenzuar 88% të buxhetit final ose 49,447,601€. Pra, realizimi i buxhetit nuk është në nivel të kënaqshëm pasi që 12% e buxhetit nuk ishte shpenzuar. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

³ Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Të hyrat vetjake të buxhetuara për shpenzim.

⁵ Të hyra nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit të ndara me ligj të buxhetit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	58,003,626	56,331,888	49,447,601	41,528,363	47,892,635
Pagat dhe Mëditjet	17,286,141	18,343,913	17,950,176	16,958,240	15,925,257
Mallrat dhe Shërbimet	9,823,419	11,593,647	9,072,901	8,421,900	8,294,192
Shërbimet komunale	1,596,459	1,340,433	987,151	1,022,455	935,411
Subvencionet dhe Transferet	4,841,929	3,290,424	2,761,002	4,079,161	3,374,488
Investimet Kapitale	24,455,678	21,763,471	18,676,371	11,046,607	19,363,287

- Rritja e buxhetit final për paga dhe mëditje prej 1,057,772€ ishte bërë nga këto burime: me vendim të Qeverisë nr. 07/80 nga kursimet me datë 12.12.2018 në vlerë prej 905,716€, nga të hyrat vetjake të bartura 103,602€, dhe donacionet në vlerë prej 48,454€.
- Buxheti për mallra dhe shërbime është rritë për 1,770,228€, për shkak të të hyrave vetjake të bartura në vlerë 691,037€, donacioneve 372,796€ dhe me vendime të Qeverisë nga kursimet, në vlerë 706,395€,
- Buxheti për komunalitet ishte reduktuar për 256,026€ me vendime të Qeverisë nga kursimet;
- Buxhetit për subvencione është zvogëluar për 1,551,505€, me vendime të Qeverisë nga kursimet, për shkak të mos realizimit subvencionimit të OJQ-ve nga ministria.
- Buxheti për shpenzime kapitale është zvogëluar për 2,692,207€ me vendime të Qeverisë nga kursimet, për shkak të mos realizimit të projekteve kapitale si dhe bartjes së buxhetit nga huamarrja në buxhetin e shkollave të Republikës së Kosovës.

Çështja B1⁶ - Planifikimi jo i mirë i projekteve kapitale

Gjetja Udhëzuesi për procesin dhe planifikimin e buxhetit kërkon “që të gjitha organizatat buxhetore të bëjnë analizë të hollësishme të projekteve kapitale që propozohen për buxhetim në vitin vijues”.

MASHT nuk kishte bërë planifikim të mirë të buxhetit për projektet kapitale pasi që në tabelën 3.2 të investimeve kapitale kishte përfshirë projekte që për nga natyra i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime. Projekte të tilla janë si: blerja e librave për fëmijë (5,600,000€), blerja e inventarit dhe pajisje laboratorike 2,000,000€.

Shkaku i planifikimit të projekteve të tilla në kategorinë e investimeve kapitale është se ministria edhe pse kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Financave (MF) që projekti i blerjes së librave të mos përfshihet në tabelën 3.2 të investimeve kapitale, MF nuk e kishte marrë në konsideratë këtë kërkesë vitin kaluar. Përderisa, projekti blerja e inventarit dhe pajisjeve laboratorike ishte rezultat i neglizhencës së ministrisë për të bërë një planifikim të mirë.

Rreziku Planifikimi jo i mirë i buxhetit, reflekton me pasqyrim të gabuar të shpenzimeve nëpër kategoritë ekonomike dhe shkakton ç’orientim në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së buxhetit vjetor, zyrtarët përgjegjës do të bëjnë analiza të mirëfillta të kërkesave buxhetore për kategorinë e investimeve kapitale në mënyrë që vetëm projektet kapitale të përfshihen në tabelën përkatëse.

⁶ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Çështja A1 Performancë jo e mirë në ekzekutimin e buxhetit

Gjetja Edhe përkundër përshtatjeve (lëvizjeve buxhetore) të cilat ishin bërë me vendime, ministria nuk kishte arritur ta shpenzoj buxhetin sipas planit të rrjedhës së parasë. Mallrat dhe shërbimet ishin shpenzuar 78%, komunalitë 74%, subvencionet 84% përderisa investimet kapitale 86%.

Kjo, si rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme të ministrisë për tu siguruar se buxheti i ndarë është shpenzuar ashtu siç është planifikuar.

Rreziku Mos realizim i buxhetit të paraparë ndikon që objektivat e parashikuara të ministrisë të mos realizohen.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të mbikëqyrë në mënyrë sistematike ecuritë buxhetore të ministrisë dhe të planifikoj me kohë të gjitha aktivitetet që do të financohen me fondet e ndara buxhetore gjatë vitit aktual.

3.2 Të hyrat

MAShT sipas regjistrave të brendshëm për vitin 2018 kishte planifikuar të inkasoj të hyra në vlerë 3,384,628€ ndërsa për periudhën 12 mujore kishte realizuar 2,674,598€ apo 79%. Në vitin 2018 nga këto të hyra MAShT-it i ishte lejuar për shpenzime shuma prej 2,655,503€, ndërsa i kishte shpenzuar 1,687,596€. Të hyrat mbliidhen nga participimi i studentëve, akreditimi i programeve akademike, qiraja etj. Nga testimi i 31 mostrave substantive dhe 5 mostra në pajtueshmëri nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për tu raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për pagat dhe mëditje ishte 18,343,913€ ndërsa shpenzimet për këtë kategori ishin 17,950,176€. Pagat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF.

Në fushën e pagave dhe shtesave tjera, ne kemi identifikuar parregullsitë si në vijim:

Çështja A2 Kompensimi i komisioneve të brendshme brenda orarit të punës

Gjetja Rregullorja nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, neni 7 përcakton llojet e kompensimeve për nëpunësit civil të cilët kanë drejt të kompensohem. Në kuadër të këtyre kompensimeve bëjnë pjesë kompensimet: për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, punën jashtë orarit gjatë fundjavës, punën jashtë orarit gjatë festave zyrtare, gjatë kohës së pushimit vjetor.

Ne kemi identifikuar se anëtarët e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në MASHT ishin kompensuar derisa takimet i kishte mbajtur gjatë orarit të rregullt të punës. Pra, komisioni i caktuar nuk kishte punuar jashtë orarit të rregullt të punës dhe për këtë nuk do të duhej të paguhet. Vlera e kompensimeve shtesë për katër anëtarët e komisionit për muajin qershor dhe korrik ishte 994€.

Arsye e këtyre pagesave ishte mungesa njohurive lidhur me aktet ligjore që e ndalojnë këtë lloj kompensimi.

Rreziku Pagesat e realizuara ndaj punonjësve nuk janë të mbështetura me bazë ligjore, dhe si të tilla, mund ta dëmtojnë buxhetin e ministrisë për vlerën e shpenzuar.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të adresoj këtë çështje dhe të siguroj se nuk do të paguhen kompensimet për stafin e brendshëm të angazhuar brenda orarit të rregullt të punës. Mjetet e paguara për kompensime për stafin të kthehen në buxhetin e ministrisë.

Çështja A3 Pagesat e bëra për profesorët në Universitetin e Prizrenit për orët mbi normë

Gjetja Kontratat e punës për orë mbi normë parasheh “Pagesa bëhet mbi bazën e orëve të mbajtura të arsyetuara sipas listës së studentëve të pranishëm në mësim dhe të verifikuar nga personi i autorizuar i fakultetit. Në kuadër të kësaj kontrate është përfshirë edhe mbajtja e provimeve dhe angazhimet tjera rreth konsultimeve për provim me studentë” .

Në dy raste kemi vërejtur se është bërë kompensimi i profesorve për orët mbi normë, edhe pse nuk kishte dëshmi se orët janë mbajtur. Vlera e paguar pa dëshmi që tregojn mbajtjen e orëve mbi normë është 500€.

Arsyeja e kësaj sipas menaxhmentit të universitetit ishte se kompensimi është bërë në emër të mbajtjes së provimeve dhe aktiviteteve tjera, edhe pse këto aktivitete ishin të parapara të kryhen në kuadër të orëve të rregullta.

Rreziku Kompensimet e tilla janë në kundërshtim me kontratën dhe kjo shkakton shpenzime të pa justifikuara të buxhetit.

Rekomandimi A3 Ministri së bashku me Rektorin duhet të siguroj që pagesat të bëhen vetëm për orët e mbajtura jashtë norme, dhe pagesat e bëra pa dëshmi për mbajtjen e orëve mësimore, të kthehen në buxhetin e ministrisë.

Çështja A4 Kompensimi anëtarëve të Senatit në Universitetin e Gjilanit pa mbajtur mbledhje

Gjetja Rregullorja e brendshme nr. 02/1486 e Universiteti të Gjilanit për pagesën e anëtarëve të senatit, respektivisht neni 4 i kësaj rregullore përcakton se pagesa për çdo anëtarë të senatit do të jetë në shumë lineare prej 70 euro bruto në muaj, nëse marrin pjesë në mbledhje.

Ne kemi identifikuar se 19 anëtarë të Senatit në Universitetin e Gjilanit të cilët ishin kompensuar për katër (4) mbledhje (janar, shkurt, mars dhe qershor 2018) të cilat nuk ishin mbajtur fare nga Senati. Vlera e kompensimeve është 5,320€ (19*4*70€=5,320€).

Pagesat e tilla kanë ndodhur për shkak të dështimit të kontrolleve nga zyrtarët përgjegjës të universitetit.

Rreziku Kompensimi i stafit të universitetit pa dëshmi të pjesëmarrjes në mbledhje, është në kundërshtim me rregulloren e brendshme dhe ndikon në dëmtimin e buxhetit të universitetit.

Rekomandimi A4 Ministri së bashku me Rektorin duhet të sigurojë se të gjitha pagesat të pa arsyetuara për kompensime ndaj anëtarëve të senatit të kthehen në buxhetin e Kosovës, dhe në të ardhmen, të siguroj zbatim të rregullore përkatese.

Çështja A5 Angazhime tjera në kundërshtim me rregulloren për të ardhura personale

Gjetja Rregullorja për të ardhura personale nr.1944 datës 05.10.2016 për stafin akademik në Universitetin Haxhi Zeka në Pejë, në nenin 5 paragrafi 4.2 përcakton se: personeli akademik që ka dy marrëdhënie pune brenda apo jashtë Universitetit Publik "Haxhi Zeka" nuk mund të marr orë mbi normë.

Në gjashtë mostra kemi identifikuar se profesorët që kanë marrëdhënie të rregullt të punës dhe kontratë me orë mbi normë me Universitetin e Pejës ishin të angazhuar me kontratë pune me honorarë edhe në universitete tjera. Dy profesor ishin të angazhuar në Universitetin e Prizrenit, një profesor në Universitetin e Ferizajt dhe tre profesor në Universitetin e Prishtinës. Angazhimet e tilla nuk janë në pajtim me rregulloren për të ardhura personale të Universitetit të Pejës. Vlen të theksohet se Universiteti i Pejës para nënshkrimit të kontratës për ore mbi normë kishte kërkuar nga profesorët të deklarojnë pagën sekondare (angazhimet tjera nëse kanë). Për mostrat e testuara, profesorët kishin deklaratat e nënshkruara se nuk kanë angazhime shtesë. Ne kemi vërejtur se profesorët kishin nënshkruar deklaratën edhe pse për periudhën e njëjtë ishin të angazhuar dhe paguar edhe në universitete tjera me honorar (pagë sekondare).

Shkaku i këtyre pagesave ishin deklaratat e pasakta të stafit akademik për angazhimet e tyre dhe monitorimi i dobët i menaxhmentit të Universitetit të Pejës ndaj personelit akademik për të vërtetuar saktësinë e këtyre deklaratave.

Rreziku Angazhimi i profesorëve në më shumë institucione arsimore sesa lejohet me rregulloret e brendshme, mund të ndikon që profesorët të mos kryejnë në mënyrë cilësore dhe me kohë detyrat e përcaktuara me kontratë.

Rekomandimi A5 Ministri së bashku me Rektorët e universiteteve duhet të siguroj monitorim ndaj personelit akademik në mënyrë që angazhimet të jenë në harmoni me rregulloren, dhe për të gjitha rastet sikurse këto të përmendura, të rishikohet mundësia e kthimit të mjeteve dhe statusi i ardhshëm i angazhimit të këtij stafi.

3.4 Menaxhimi i Personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me rekrutimin, mbulimin e pozitave me UD, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme, ne kemi vlerësuar fushën e menaxhimit të personelit dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja A6 – Të punësuarit sipas marrëveshjes së Brukselit

Gjetja

Duke u bazuar në marrëveshjen e Brukselit, përkatësisht në Ligjin nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës “Mbrojta Civile” e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore.

Në MASHT, pas një procesi të rekrutimit me akt emërimi ishin integruar 32 nëpunës të komunitetit serb, ish pjesëtarë të “Mbrojtjes Civile”. Këta punonjës ishin planifikuar të sistemohen nëpër komunat në pjesën veriore të Kosovës. Megjithatë, në aktemërimet e tyre, të punësuarit janë sistemuar në pozita të caktuara brenda departamenteve përkatëse në ministri.

Për zyrtarët e lartcekur ministria, nuk ka dëshmi për ta konfirmuar paraqitjen e tyre në vendin e punës, siç i obligon Rregullorja nr. 05/2010 e orarit të punës e hartuar nga Ministria e Administratës Publike, përderisa ministria kishte bërë pagesën e rregullt të pagave të tyre. Vlera financiare për shpenzimet e pagave për vitin 2018, për këta 32 zyrtarë ishte 134,657€.

Kjo ka ndodhur për shkak se nuk janë zbatuar kontrole menaxheriale për të siguruar se të gjithë të punësuarit janë të pranishëm në vendin e punës gjatë orarit të punës dhe arsyeve tjera, përfshirë edhe rrethanat politike.

Rreziku

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë, nuk kanë bazë të qartë ligjore dhe nuk janë pagesa të rregullta. Si të tilla, mund ta dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të ndërmerret të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri duhet ta adresoj këtë çështje edhe në Qeveri.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalit në vitin 2018 ishte 12,934,080€. Prej tyre ishin shpenzuar 10,060,052€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për furnizim me ushqim për Qendrën e Studentëve, furnizim me material zyrtar, derivate të naftës, shërbime kontraktuese, shërbime komunale, udhëtime zyrtare, shërbime të mirëmbajtjes etj.

Çështja B2 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Në 21 pagesa për mallra dhe shërbime, kemi identifikuar se zotimi dhe urdhër blerja ishte bërë pas pranimit të faturës. Një praktikë e tillë po përsëritet vit pas viti për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme.

Rreziku Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 3,290,424€. Prej tyre, në vitin 2018 ishin shpenzuar 2,761,002€. Kryesisht këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesat e bëra nga MASHT sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e ndryshme si: Sheffield-it, USAID, Fulbright, projektin e Loyola-s si dhe për përkrahjen e projekteve shkencore.

Nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur, përveç çështjeve të përmendura te kapitulli qeverisja e mirë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 21,763,471€, prej tyre ishin shpenzuar 18,676,371€ apo 86%. Këto shpenzime kanë të bëjnë me: ndërtimin e shkollave, furnizimi me pajisje për salla të edukatës fizike, furnizim me inventarë shkollor etj. Gjatë vitit 2018 fusha e investimeve kapitale ishte përcjell me disa mangësi të cilat po i përshkruajmë më poshtë.

Çështja A7 - Ekzekutimi i pagesave për punë të pa përfunduara

Gjetja

Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.20 përcakton se “menaxherët e Projektit duhet të sigurojnë që operatori ekonomik i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës”.

Te projekti "Ndërtimi i Shkollës Fillore në fshatin Braboniq" të Mitrovicës në vlerë 1,179,812€, kemi identifikuar se ishin paguar pozicione të punëve të caktuara të cilat nuk ishin kryer. Ne kemi testuar pagesat 55,000€, 100,000€ dhe 51,512€ që ndërlidhen me këtë projekt, dhe me datën 05.04.2019, së bashku me menaxherin e projektit kemi ekzaminuar projektin dhe kemi vërejtur që pozicionet në vijim ishin të pa përfunduara:

10.1 (furnizim me material si dhe vendosja e pllakave të qeramikës në dysheme dhe muret e kthinave të parapara me projekt, të jenë të klasit të parë, aprovimin e mostrës e bënë organi mbikëqyrës) ku vlera për këtë pozicion është 7,440€ ($930\text{m}^2 \cdot 8\text{€ m}^2 = 7,440\text{€}$),

14.22 (Furnizim me material dhe montimi i dritares së aluminit me hapje sipas skemës W1, profili p100, alumin, dimensionet 350-250cm) ku vlera për këtë pozicion është 800€ ($2\text{ copë} \cdot 400\text{€} = 800\text{€}$),

14.25 (Furnizim me material dhe montimi i dritares së aluminit me hapje sipas skemës W4, profili p100, alumin, dimensionet 450-250cm) ku vlera për këtë pozicion është 14,300€ ($22\text{ copë} \cdot 650\text{€} = 14,300\text{€}$),

15.1 (Furnizim me material dhe punimi i fasadës termo izoluese në pjesën e jashtme me fasadë ku shtresat e aplikuar janë ngjitësit stiropol, grund baza së bashku me stiroporin N4 10cm, ngjitës rrjeta rabbit, fasada me granul 2mm e ngjyrosur në kofa, material i klasit të parë) ku vlera për këtë pozicion është 23,265€ ($1,875\text{m}^2 \cdot 11\text{€ m}^2 = 20,625\text{€}$ dhe $240\text{m}^2 \cdot 11 = 2,640\text{€}$);

16.3 (Furnizimi me material si dhe vendosja e kabëzave të betonit me trashësi 8 cm në trotuaret, staza të ecjes, parkingje etj. ku përfshihet gërmimi dhe transporti 40cm, ngjeshja, zhavorri 0-6 dhe 0-32 (20+15) cm, ngjeshja me cilindër dhe vendosja e kabëzave sipas projektit) ku vlera për këtë pozicion është 1,400€ ($350\text{m}^2 \cdot 4\text{€ m}^2 = 1,400\text{€}$),

Pra, të gjitha pozicionet e sipërpërmendura nuk ishin të realizuara deri me datën 05.04.2019 derisa ato ishin paguar në fund të vitit 2018. Vlera e këtyre pozicioneve të pa kryera është 47,205€. Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheri i projektit kishte nënshkruar raportet që punët janë përfunduar sipas kushteve të kontratës, përderisa ato ende nuk ishin kryer.

Vlen të theksohet se pas komunikimit tonë të kësaj çështje, menaxhmenti i ministrisë kishte marrë masa të menjëhershme, dhe me datën 10.05.2019, kompania punë kryerëse i kishte kthyer 47,200€, në buxhetin e Kosovës.

Rreziku Nënshkrimi i raporteve nga menaxheri kontratës, para se punimet e kontraktuara të jenë kryer, rritë rrezikun e dëmtimit të buxhetit të ministrisë si dhe mos përfitimin e vlerës për para.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të siguroj mbikëqyrje më efektive të projekteve në mënyrë që ekzekutimi i punimeve të kryhet në pajtim me kushtet e kontratës dhe pagesat të kryhen vetëm për punët e përfunduara.

Çështja B3 - Sigurimi i ekzekutimit jo në harmoni me kërkesat ligjore

Gjetja Bazuar në rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, pika 30, Siguria e Ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës, dhe mbetet valide për një periudhë prej 30 ditë pas kompletimit të kontratës. Gjatë testimit të aktiviteteve të prokurimit në dy (2) raste identifikua se sigurimi i ekzekutimit nuk mbulonte kohëzgjatjen e kontratës. Siguria e Ekzekutimit ishte jo e plotë për këto raste:

Kontrata “Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve Yllka” në Prishtinë në vlerë 782,537€, ishte lidhë për periudhën 3 vjeçare ndërsa Operatori Ekonomik (OE) në momentin e nënshkrimit të kontratës, kishte ofruar sigurinë e ekzekutimit vetëm për një vit.

Kontrata “Ndërtimi i shkollës profesionale në Ferizaj-faza I” në vlerë 665,442€, kontrata ishte për periudhën dyvjeçare, ndërsa OE në momentin e nënshkrimit të kontratës kishte ofruar sigurinë e ekzekutimit vetëm për një vit.

Arsyeja e lidhje së kontratave për projekte kapitale me siguri të ekzekutimit më të shkurtër se periudha e përmbushjes të kontratës, ishte paaftësia e zyrës së prokurimit për t’i ndjek kërkesat e dala nga rregulla dhe udhëzuesi operativ i prokurimit. Edhe në raportin e auditimit të vitit të kaluar, kishte raste të njëjta kur siguria e ekzekutimit nuk mbulonte periudhën e përmbushjes së kontratës.

Rreziku Ofrimi i sigurimit të ekzekutimit të kontratës për periudhë më të shkurtër se sa kohëzgjatja e realizimit të projekteve deri në pranimin final të punimeve, pamundëson ndëshkimin eventual ndaj operatorëve në rastet kur kontrata nuk përmbushet si dhe rrezikon vet realizimin e projekteve.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të aplikoj kontrolle përkatëse dhe të siguroj se me rastin e nënshkrimit të kontratave zyra e prokurimit vendosmërisht zbaton kërkesat që siguria e ekzekutimit të mbuloj tërë periudhën e përmbushjes së kontratave.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë mbi 1,000€ e prezantuar në PFV e vitit 2018 është 146,059,491€, përderisa në vitin 2017 ishin 136,894,093€. Vlera e pasurisë nën 1,000€ për vitin 2018 ishte 2,847,000€. Mangësitë e evidentuara lidhur me prezantimin dhe vlerën e pasurive i kemi shpalosur te kapitulli i PFV-ve. Përveç çështjeve të përmendura tek kapitulli i PFV-ve, ne kemi identifikuar çështjen si më poshtë:

Çështja B4 - Inventarizimi i pasurive jo në pajtim me rregulloren

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19 përcakton se ndër përgjegjësitë e komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare janë: verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurive jo financiare, krahasimi i gjendjes së inventarizuar, identifikimi e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur.

MAShT, edhe pse kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurisë, ky komision nuk kishte kryer detyrat siç parashihen me rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, sepse nuk kishte bërë inventarizimin për të gjitha pasuritë sipas programeve, që janë në pronësi dhe kontroll të ministrisë.

Po ashtu, nuk kishte bërë identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur, krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, si dhe nuk ishte bërë identifikimin e pasurive të dëmtuara dhe atyre jashtë përdorimit.

Shkaku i mos kryerjes së inventarizimit ishte mungesa e kompetencës dhe përgatitjet e pamjaftueshme të komisionit për ta bërë inventarizimin e pasurive jo financiare në pajtim me rregulloren.

Rreziku Mos inventarizimi i pasurive jo financiare për të gjitha programet e ministrisë, rritë rrezikun e ekzistencës së pasurive, keqmenaxhimin dhe mundësinë e shpërdorimit të pasurive jo financiare. Rrjedhimisht, kjo ndikon që vlera e pasurive të mos jetë raportuar si e plotë dhe e saktë.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të siguroj që çdo fundvit të formoj komisione kompetente të inventarizimit të pasurive në kuadër të të gjitha programeve të ministrisë, si dhe rezultatet e inventarizimit të reflektohen në gjendjen e prezantuar në pasqyra financiare. Po ashtu, në rast nevojë, për anëtarët e komisioneve, të organizohen edhe trajnime të veçanta në mënyrë që procesi i inventarizimit të kryhet me kompetencë dhe në kohën e duhur.

3.9 Llogaritë e Arkëtueshme

Pasqyra e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2018 ishte 50,060€ dhe krahasuar me vitin e kaluar (187,210€) është zvogëluar për 137,150€. Llogaritë e arkëtueshme kanë të bëjnë me akreditimin e disa programeve, me inkasimit e qirasë, etj.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 928,760€, që përafërsisht është e njëjtë me atë të vitit kaluar (948,430€). Obligimet e pa paguara kryesisht kanë të bëjnë me kategorinë mallra dhe shërbime, dhe subvencione e transfere. Arsye e mos shlyerjes se këtyre obligimeve janë: pranimi i disa faturave me vonesë, mos kompletimi i dokumentacionit për pagesë etj. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

Çështja B5 Raportimi jo i plotë i obligimeve të pa paguara

Gjetja Rregulla Financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të pa paguara përcakton se Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose obligimeve tjera në SIMFK në përputhje me rregullat e MFK-së, brenda tri (3) ditë pune pas pranimi të faturës.

Ne kemi identifikuar se një faturë në vlerë 9,850€ e cila ishte e protokolluar me datën 26.12.2013 nuk ishte raportuar si obligim i pa paguar në PFV-të e vitit 2018, ndërsa me datën 17.01.2019 e njëjta ishte ekzekutuar përmes një urdhëri përmbarimor në shumën prej 12,634€, duke llogaritur edhe kamatën dhe shpenzimet tjera përcjellëse.

Shkaku i mos raportimit është mungesa e kontrollit të brendshëm. Të gjitha këto ndikojnë që obligimet të mos raportohen saktë në PVF.

Rreziku Mos përfshirja e të gjitha obligimeve të pa paguara në PFV ndikon që obligimet të mos jenë të sakta dhe të plota, dhe ministria të bëj pagesa për obligimet të cilat nuk janë raportuar.

Rekomandimi B5 Ministri duhet të siguroj që të gjitha obligimet e papaguara të raportohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në PFV, dhe më pas, me prioritet paguhen gjatë muajve të parë të vitit vijues.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MASHT-it veçanërisht në lidhje me monitorimin e projekteve kapitale dhe fushës së personelit. Po ashtu, vërehen dobësi të theksuara edhe në menaxhimin e pasurive. Procesi i monitorimit për zbatim të rekomandimeve, qoftë nga auditimi i jashtëm apo i brendshëm, tregon se menaxhmenti nuk i ka trajtuar seriozisht çështjet e ngritura dhe mungesa e vëmendjes së menaxhmentit ndaj këtyre çështjeve hapësirën që sistemi i kontrollit të brendshëm të mos përmirësohet.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në raportin e auditimit për vitin 2017, kemi dhënë rekomandime për fusha të ndryshme në mënyrë që ato të përmirësohen. Ne kemi vërejtur se në vitin 2018, një numër shumë i vogël i rekomandimeve ishte zbatuar, me ç'rast kjo ka shkaktuar që në disa fusha, problemet të përsëriten.

MASHT me datën 02.10.2018, kishte bërë dy propozime për rend dite në qeveri për aprovimin në parim të nismës për Aprovimin e kërkesave të MASHT për ndarjen e mjeteve financiare për "OJQ - Asociation Loyola Gymnasium". Njëra kërkesë ishte për rimbursimin e pagave për vitin 2018 në shumën prej 308,858€, dhe tjetra për themelimin dhe funksionalizimin e shkollës së lartë profesionale me sistem tre vjeçar me plan program të shkollave profesionale në Gjermani "Loyola Profesional" 300,000€, dhe 50,000€ për shpenzime vjetore prej vitit 2019. Qeveria me vendim nr. 10/67 të datës 02.10.2018, i aprovon kërkesat e MASHT me ç'rast ndan 658,858€ nga Ministria e Financave në nën programin kontigjencat në Ministrinë e Financave me kod 28900 nga kategoria shpenzimeve subvencione dhe transfere. Fondet janë transferuar në MASHT në programin administrata qendrore me kod 11308 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere, ku MF dhe MASHT ishin obliguar për zbatimin e këtij vendimi.

Me datën 05.11.2018, bazuar në vendimin e qeverisë, MASHT kishte paguar 658,858€, Gjimnazin Loyola. Edhe pse ishte bërë pagesa, MASHT nuk kishte lidhë kontratë siç parashihet me nenin 22 të Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. Më tej, nuk ishte caktuar asnjë zyrtar monitorues i kontratës, siç kërkohet me nenin 23 të kësaj rregulloreje. Ministria për vitin 2018, nuk kishte kurrfarë kontrolli për të monitoruar nëse mjetet e dhëna janë duke u shpenzuar në pajtim me qëllimin e dhënë.

Vlen të theksohet se MASHT kishte një Memorandum të Mirëkuptimit (MM) me OJQ Loyola që nga viti 2004 dhe një aneks tjetër në vitin 2012, ku parashihet që ministria t'i paguaj pagat e stafit dhe mësimdhënësit në nivel me pagat e mësimdhënësve në shkollat publike, ku ministri i MASHT-it me datën 22.02.2018 kishte shfuqizuar pikën 2 të nenit 2 të MM që parashihen obligimet financiare të MASHT ndaj Loyol-as.

Ne kemi identifikuar se në Qendrën e Studentëve pranimi i mallit bëhet nga zyrtarët⁷ e kësaj qendre të cilët i nënshkruajnë vetëm fletëdërgesat e pranimit të mallit, por pa ndonjë procesverbal apo raport të pranimit të mallrave, siç kërkohet me rregullore. Pas komunikimit të kësaj çështje, menaxhmenti i kësaj qendre me datën 30.04.2019 kishte emëruar një komision për pranim të mallit në depon ushqimore.

Rekomandimi i dhënë nga ZKA që nga viti 2015 që ndërlidhet me auditorin e brendshëm në Universitetin e Prizrenit (UPz) ende nuk është adresuar. Auditori i brendshëm në UPz vazhdon të paguhet pa kryer asnjë raport të auditimit për shkak se Ministria dhe UPz nuk ka arritur një dakordim për mënyrën e angazhimit.

MASHT me datën 26.09.2018, kishte hartuar dhe ishte aprovuar në qeveri Rregullorja (QRK) nr. 14/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe në bazë të kësaj rregullore kishte filluar procesin e riorganizimit të brendshëm. Sipas kësaj rregullore parashihen të jenë pesë (5) departamente të ministrisë, nga 8 sa ishin më herët.

MASHT me 30.10.2018, kishte shpall konkurs të brendshëm për plotësimin e pozitave të parapara me rregulloren. Me 04.10.2018 me vendime të Sekretarit të Përgjithshëm kishte caktuar si Ushtrues Detyre (UD) tre drejtor të cilët kanë qenë me akt emërimi dhe dy (2) drejtorë të tjerë të rijnë si UD, ndërsa nuk i kishte sistemuar 5 drejtor tjerë që kanë qenë me herët në pozita të tilla. Pas ankesave të bëra nga drejtorët që mbanin këto pozita, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil (KPMSHC) me datën 21.12.2018 kishte nxjerr vendim për anulim të konkursit sepse kishte identifikuar se citojmë: "MASHT nuk i kishte ndërmarrë të gjitha veprimet ashtu siç parashihet me nenin 32 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës". Po ashtu MASHT sipas KPMSHC-së, citojmë "nuk kishte ndërmarr asnjë veprim që të gjej pozita ekuivalente ankuesve ashtu siç kërkohet me nenin 4 nën paragrafin 1.3 të Rregullores nr.08/2012- për Nëpunës Civil Tepricë". Prandaj MASHT me 04.01.2019, kishte marr vendim për anulim të konkursit. Si rezultat i gjithë kësaj, paguhen 10 persona⁸ për këto pozita në vend se të ishin paguar pesë (5), siç e parasheh rregullorja e re.

Situatë e ngjashme është edhe me udhëheqësit e divizioneve ku si rezultat i riorganizimit, katër (4) udhëheqës të divizionit nuk ishin sistemuar në pozita të udhëheqjes, por në vend të tyre janë caktuar punonjës tjerë me vendime në cilësinë e UD. Vlen të theksohet se për pozitat e udhëheqësve të divizionit nuk është iniciuar ndonjë proces rekrutimi. Pra, ministria ende nuk e ka përmbyll procesin e riorganizimit të brendshëm.

⁷ Në kuadër të QS është i formuar një komision në cilësinë e inspektimit të brendshëm i cili gjatë furnizimit me mall nënshkruan fletëdërgesat, dhe nuk harton raporte të shkruara për furnizimet e pranuar.

⁸ Dy persona të rijnë si UD Drejtor Departamenti dhe 8 personat që kanë ushtruar me akt emërimi këto pozita

Nga programi buxhetor i Agjencionit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur (AAAPRr) paguhen 39 mësimdhënës të cilët ushtrojnë veprimtarinë në shkollën e mesme ekonomike "Ymer Prizreni" që është nën menaxhimin e drejtorisë komunale të arsimit në Prizren. Pra, shkolla e mesme profesionale nuk është nën strukturën e organizimit të Qendrës së Kompetencës së AAAPRr, e cila është nën program i MASHT-it. Prandaj, MASHT duhet inicioj zgjidhjen e këtij problemi në koordinim me MF dhe Komunën e Prizrenit dhe çështja e financimit t'i kalohet DKA të Prizrenit.

Neni 6 i rregullores 04/2017 përcakton që ofruesit e mbështetjes financiare të përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Një plan të tillë, MASHT nuk e kishte përgatitur.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Në planin vjetor të auditimit për vitin 2018, NJAB kishte planifikuar që të kryej nëntë (9) auditime të rregullta, ndërsa kishte përfunduar tetë (8) raporte të auditimit dhe një me kërkesë të menaxhmentit. Pra, NJAB kishte realizuar planin e punës sipas objektivave paraprake.

Raportet e auditimit kishin të bëjnë me: (a) Shpenzimet në Qendrën e Studentëve, ku fokus kishte aktivitetet e vitit 2017, (b) buxhetin dhe financat në Universitetin e Prizrenit dhe Universitetin e Pejës të vitit 2018, (c) fusha e prokurimit, personelit, shpenzimet në administratën qendrore, shpenzimet për vitin 2018 dhe (d) të hyrat në Agjencionin për Aftësim Profesional për vitin 2017. (e) Raporti për Agjencionin e Akreditimit (ky raport ishte bërë me kërkesë të menaxhmentit) dhe (f) menaxhimi i autoparkut gjatë vitit 2017.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër takime gjatë vitit 2018 ku në takimin e parë dhe të dytë ishin diskutuar raportet e auditimit të NJAB të cilët mbulonin periudhën e vitit 2017 dhe një pjesë të vitit 2018, ndërsa në dy takimet e mbajtura në dhjetor ishin diskutuar raportet të cilat mbulonin periudhën e vitit 2018.

Raportet e auditimit ishin të nivelit më cilësor, në krahasim me vitin e kaluar, gjetjet e prezantuar në raporte ishin të dokumentuar me dëshmi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti ka dizajnuar sisteme të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, përfshirë strukturën organizative dhe linjat e llogaridhënies. Sekretari i Përgjithshëm mban takime të rregullta javore me Drejtor të Departamenteve. Për këto takime përgatiten procesverbale ku pasqyrohen aktivitetet e ndryshme operative.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të MASHT ka rezultuar në 21 rekomandime. MASHT kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohen rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2018, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar; katër (4) ishin në proces (pjesërisht), gjashtë (6) tjera nuk janë adresuar ende, dhe pesë (5) rekomandime të mbyllura të pa zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV-Opiniononi i auditimit (rek. 1)	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime konkrete lidhur me bartjen e pronësisë për shkollat e ndërtuara nga MASHT te komunat përkatëse dhe se këto pasuri duhet të largohen nga regjistri i pasurive të ministrisë.	Menaxhmenti kishte ndërmarr veprim konkret duke e adresuar pjesërisht çështjen e ngritur në raportin e viti të kaluar.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar.
2	PFV (rek. 2)	Ministri duhet të iniciojë rishikimin e Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032 dhe të udhëzimit administrativ nr.13/2016, me qëllim të shmangies së paqartësive për furnizim me tekste shkollore. Si dhe të mbajë në konsideratë, që projektet që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve të mos planifikohen në kategorinë e investimeve kapitale.	MASHT respektivisht Sekretari i Përgjithshëm kishte nxjerr vendim me 16.11.2018 duke emëruar një grup punues për rishikim të Udhëzimit Administrative 03/2016.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar.
3	Detyrimet kontingjente (rek. 3)	Ministri të sigurojë se bëhet prezantimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve kontingjente. Dhe se deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme	Nuk kemi identifikuar ndonjë rast për të ngritur prandaj konsiderojmë që detyrimet kontingjente janë të plota.	Rekomandimi i zbatuar.
4	Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të siguroj se bëhen analiza të mirëfillta ndaj kërkesave buxhetore për kategoritë ekonomike në mënyrë që	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarr	Rekomandimi i pa zbatuar.

		përshtatjet buxhetore të jenë sa më të vogla, duke mos rrezikuar arritjen e objektivave të planifikuara.	ndonjë veprim konkret për te adresuar këtë çështje.	
5	Regjistrimi i të hyrave jo në kode adekuate.	Ministri duhet të siguroj kontrolle shtesë që regjistrimi i të hyrave vetanake bëhet në kode adekuate siç parashihet me planin kontabël.	Menaxhmenti kishte ndërmarr veprime të caktuara dhe të hyrat nga akreditimi i kishte regjistruar në kodin e licencave nga arsimi privat.	Rekomandimi i zbatuar.
6	Menaxhimi i Personelit	Ministri duhet të marrë masa të menjëhershëm që për pozitat të cilat mbulohen me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta në pajtim me kërkesat ligjore.	Menaxhmenti nuk kishte mbuluar pozitat e tilla në pozita të rregullta.	Rekomandimi i pa zbatuar.
7	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj që procedurat e prokurimit të zhvillohen me kohë për ta zgjedhur operatorin për mirëmbajtje në mënyrë që të shmangët rreziku nga mosfunksionimi i SEMS-it.	UPZ kishte ndërmarr hapa konkret dhe kishte lidhur kontratën për mirëmbajtjen e SEMS-it.	Rekomandimi i zbatuar.
8	Mallrat dhe shërbimet,	Ministri të siguroj që para zhvillimit të procedurave të prokurimit të merr aprovimet nga zyrtarët kyç për disponueshmëri të mjeteve.	Kontrata veç se ka përfunduar dhe si i tillë rekomandimi është mbyllur.	Rekomandimi i mbyllur i pa zbatuar.
9	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm dhe të ndërmerr masat e duhura për të siguruar që dështimet e ngjashme nuk	Menaxhmenti kishte ndërmarr	Rekomandimi i pa

		do të ndodhin në të ardhmen.	veprim konkret për te përmirësuar këtë dukuri.	zbatuar.
10	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj se marrëveshjet e nënshkruara në mes Institutit të Historisë dhe hulumtuesve për hulumtimin e Historisë së Kosovës do të respektohen në përpikëri duke mos tejkaluar vlerat e tyre.	Kontrata veç se ka përfunduar dhe si i tillë rekomandi mi është mbyllur.	Rekomandi m i mbyllur i pa zbatuar.
11	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj që në raste të tilla të aplikohen procedura të prokurimit sipas kërkesave të parapara nga rregullat dhe udhëzuesit operativ të prokurimit.	UPZ kishte ndërmarr veprime konkrete duke i zhvilluar procedurat e prokurimit për mbikëqyrje te projekteve kapitale.	Rekomandi m i zbatuar.
12	Investimet Kapitale	Ministri duhet të siguroj se me rastin e nënshkrimit të kontratave zyra e prokurimit të sigurohet se siguria e ekzekutimit të kontratës e mbulon periudhën e kërkuar të kontratës.	Gjendja nuk është përmirësuar pasi që edhe ne vitin 2018 kishte raste te tilla.	Rekomandi m i pa zbatuar.
13	Investimet Kapitale	Ministri duhet të siguroj se nuk do të hyj në obligime kontraktuale më shumë se sa ndarjet buxhetore.	Kontrata veç se ka përfunduar dhe si i tillë rekomandi mi është mbyllur.	Rekomandi m i mbyllur i pa zbatuar.
14	Investimet Kapitale	Ministri duhet t'i shtoj kontrollet për të siguruar se vlera e kontratave të jetë në përputhje me ofertën financiar të ofruar nga operatori ekonomik. Po ashtu, të rishikohet mundësia e korrigjimit të kontratës duke e harmonizuar me vlerën reale të ofertës	Menaxhmen ti kishte ndërmarr veprimet e duhura dhe	Rekomandi m i zbatuar.

		financiare.	janë bere korrigjimet e duhura.	
15	Investimet Kapitale	Ministri duhet të siguroj se në rastet e tejkalimit të sasive të cilat ndikojnë në çmimin total të kontratës zyra e prokurimit të bëjë ndryshimin e kontratës siç parashihet me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik.	Menaxhmenti kishte ndërmarr veprimet duke e lidhur aneks kontratën për projektin e tille.	Rekomandimi i zbatuar.
16	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të siguroj se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që menaxhimi i pasurisë bëhet përmes regjistrimit të plotë dhe të saktë të SIMFK-së si dhe të sistemit të e-pasurisë.	MAShT nuk ka arritur të siguroj funksionimin e plote të sistemi të e-pasurisë kështu që gjendja e pasurive nën 1000€ nuk është e plote.	Rekomandimi i pa zbatuar.
17	Obligimet e papaguara	Ministri duhet t'i jap prioritet shlyerjes së obligimeve të vitit 2017, për shkak se ministria mund të paditet nga operatorët ekonomik, po ashtu duhet të siguroj regjistrim të saktë të obligimeve.	Edhe pse ministria ka bere raportim të obligimeve mujore në Thesar nuk kishte raportuar të gjitha obligimet në PFV e vitit 2018.	Rekomandimi i pa zbatuar.
18	Pagesa vendimeve gjyqësore	Për t'iu shmangur situatave të ngjashme, Ministri duhet të siguroj që legjislacioni sekondar të jetë në harmoni me ligjet dhe të forcoj disiplinën financiare që të gjitha obligimet të paguhen me kohë.	MAShT në vitin 2016 kishte hartuar UA për akreditim. Nuk ka ndonjë veprim	Rekomandimi i mbyllur i pa zbatuar.

			konkret.	
19	Progresi i zbatimit të rekomandimeve.	Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	MASHT ka përgatitur planin e veprimit duke përcaktuar afatet e zbatimit të rekomandimeve. Mbeten ende rekomandime për tu zbatuar.	Rekomandimi mbyllur i pa zbatuar.
20	Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë se Plani i NJAB mbështetet në fushat me rrezik dhe ndihmon aktivitetet operative në vazhdim. Komiteti i Auditimit duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.	Raportet e NJAB kanë shënuar një progres të mirë dhe po ashtu kanë fokus kryesisht vitin 2018.	Rekomandimi i zbatuar.
21	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duke përfshirë të gjitha programet e MASHT-it që kanë njësi të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e MASHT-it dhe menaxhmenteve respektive.	Menaxhmenti kishte ndërmarr veprime pasi që UPz dhe Universiteti i Ferizajt kanë hartuar strategjitë e tyre ndërsa pjesa tjetër e çështjeve që ndërlidhen këtë rekomandim nuk është adresuar në nivelin e duhur.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar.
Nr.	Fusha e	Rekomandimet e vitit 2018		

	auditimit	
C1	PFV	<p>Ministri duhet të ndërmerr veprime konkrete lidhur me bartjen e pronësisë për shkollat e ndërtuara nga MASHT te komunat përkatëse dhe se këto pasuri duhet të largohen nga regjistri i pasurive të ministrisë. Më tutje, të shtoj kontrollet për të siguruar se të gjitha programet që janë në kuadër të MASHT do të përdorin sistemin e e-pasurisë për të siguruar se pasuria jokapitale e prezantuar në PFV paraqet një pamje të drejtë dhe të saktë.</p> <p>Gjithashtu, Ministri duhet të siguroj se projektet që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve të mos planifikohen në kategorinë e investimeve kapitale por në kategorinë adekuatë.</p>
B1	Planifikim jo i mirë i projekteve	Ministri duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së buxhetit vjetor, zyrtarët përgjegjës do të bëjnë analiza të mirëfillta të kërkesave buxhetore për kategorinë e investimeve kapitale në mënyrë që vetëm projektet kapitale të përfshihen në tabelën përkatëse.
A1	Realizim jo i mirë i buxhetit	Ministri duhet të mbikëqyrë në mënyrë sistematike ecurinë buxhetore të ministrisë dhe të planifikoj me kohë të gjitha aktivitetet që do të financohen me fondet e ndara buxhetore gjatë vitit aktual.
A2	Kompensimi i komisioneve të brendshme brenda orarit të punës	Ministri duhet të adresoj këtë çështje dhe të siguroj se nuk do të paguhen kompensimet për stafin e brendshëm të angazhuar brenda orarit të rregullt të punës. Mjetet e paguara për kompensime për stafin të kthehen në buxhetin e ministrisë.
A3	Pagesat e bëra për profesorët në Universitetin e Prizrenit për pa u mbajtur orët mbi normë	Ministri së bashku me Rektoren duhet të siguroj që pagesat të bëhen vetëm për orët e mbajtura jashtë norme dhe pagesat e bëra pa dëshmi për mbajtjen orëve mësimore, të kthehen në buxhetin e ministrisë.
A4	Kompensimi anëtarëve të Senatit në Universitetin e Gjilanit pa mbajtur mbledhje	Ministri së bashku me Rektoren duhet të sigurojë se të gjitha pagesat të pa arsyetuara për kompensime ndaj anëtarëve të senatit të kthehen në buxhetin e Kosovës dhe dhe në të ardhmen, të siguroj zbatim të rregullores përkatëse.
A5	Angazhime tjera në kundërshtim	Ministri së bashku me Rektoret e universiteteve duhet të siguroj monitorim ndaj personelit akademik në mënyrë që angazhimet të jenë në harmoni me

	me rregulloren për të ardhura personale	rregulloren dhe për të gjitha rastet sikurse këto të përmendura të ndalohet dhe të rishikohet mundësia e kthimit të mjeteve dhe statusi i ardhshëm i angazhimit të këtij stafi.
A6	Të punësuarit sipas marrëveshjes së Brukselit	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri duhet ta adresoj këtë çështje edhe në Qeveri.
B2	Mangësi në procedimin e pagesave	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin të procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.
A7	Ekzekutimi i pagesave për punë të pa përfunduara	Ministri duhet të merr masa të menjëhershme që pagesat e bëra për punët e pa kryera t'i kthehen buxhetit të ministrisë brenda një afati sa më të shkurtër, si dhe të siguroj një mbikëqyrje më efektive të projekteve në mënyrë që ekzekutimi i punimeve të kryhet në pajtim me kushtet e kontratës dhe pagesat të kryhen vetëm për punët e përfunduara.
B3	Sigurimi i ekzekutimit jo në harmoni me kërkesat ligjore	Ministri duhet të aplikoj kontrole përkatëse dhe të siguroj se me rastin e nënshkrimit të kontratave zyra e prokurimit vendosmërisht zbaton kërkesat që siguria e ekzekutimit të mbuloj tërë periudhën e përmbushjes së kontratave.
B4	Inventarizimi i pasurive jo në pajtim me rregulloren	Ministri duhet të siguroj që çdo fundvit të formoj komisione kompetente të inventarizimit të pasurive në kuadër të të gjitha programeve të ministrisë, si dhe rezultatet e inventarizimit të reflektohen në gjendjen e prezantuar në pasqyra financiare. Po ashtu, në rast nevojë, për anëtarët e komisioneve, të organizohen edhe trajnime të veçanta në mënyrë që procesi i inventarizimit të kryhet me kompetencë dhe në kohën e duhur.
B5	Raportimi jo i plotë i obligimeve të pa paguara	Ministri duhet të siguroj që të gjitha obligimet e papaguara të raportohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në PFV dhe më pas, me prioritet paguhen gjatë muajve të parë të vitit vijues.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi

I



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republ
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRAKURPËZEMAR:			
DITË/ARBEJEN KËSHTU/ARBE			
DATE/ARBEJEN SUBMITTED:			
Kopila Org. Org. Unit	Shifër Klasifik. Class. Code	Nr. Prot. Prot. No.	Nr. Fajdeve No. Pages
03	47	906	1

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"); **DRAFT RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E ARSIMIT SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Shyqiri Bytyqi 

Ministër i i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë,

Data: 05.06.2019 Prishtinë,